

Pasqyrimi i aktivitetit të AIDSSH së datës 25.01.2024: Themelohet në Korçë Klubit të Librit

[Vizion Plus TV](#)

"Të mësojmë nga e shkuara"/Autoriteti për dosjet e ish sigurimit prezanton klubin e librit

<https://www.youtube.com/watch?v=FouCauBuxcE>

Autoriteti për Informim mbi dokumente të ish-Sigurimit në ditën ndërkombëtare të holokaustit ka prezantuar për herë të parë në Korçë, Klubin e Librit, me moton “Të mësojmë nga e shkuara”. Kryetarja Gentiana Sula ka kërkuar më shumë mbështetje financiare për botimin e historive njerëzore të periudhës së komunizmit. Sipas saj autorët e kanë të pamundur të botojnë me tirazh të madh këto histori.

GENTIANA SULA KRYETARE E AIDSSH “Shpesh herë këto botime vijnë nga njerëz që nuk janë të fushës së letërsisë janë njerëz të familjes, qytetarë të angazhuar, të cilët shkruajnë pa e pasur zejen e të botuarit ndaj dhe tirazhi është në numër të vogël.

”Botimet për historitë e kësaj periudhe duhet të bëhen pjesë e teksteve shkollore, që brezi i ri të njihet më mirë me të shkuarën komuniste. GENTIANA SULAKRYETARE E AIDSSH “Këto libra ne në autoritet i hasim dhe i kemi burime të informimit në një kohë kur shpesh s’është jetuar por siç dihet këto libra e kanë të vështirë rrugën për të kaluar deri te publiku. sidomos tek brezat e rinj, ku autoriteti ka dhe një mandat të përcaktuar në ligj që është edukimi qytetar.”

Në çeljen e klubit të librit ishte i pranishëm edhe shkrimtari Marçel Hila, i cili përmes romanit të tij “Rrufeja në shtëpinë e mikpritësit”, solli copëza historie nga Lufta e Dytë Botërore, duke treguar se si populli hebre është mikpritur dhe strehuar nga shqiptarët.

Radio Televizioni Shqiptar

<https://www.youtube.com/watch?v=JhNSBVB1YFI>

Autoriteti i Dosjeve prezanton “Klubin e Librit” - Sula: Duhet mbështetje për botimin e historive

Agjencia Telegrafike Shqiptare

AIDSSH: Themelohet në Korçë klubi i librit “Mësojmë nga e shkuara 1944-1991”

<https://ata.gov.al/2024/01/26/aidssh-themelohet-ne-korce-klubi-i-librit-mesojme-nga-e-shkuara-1944-1991/>

Themelohet në Korçë klubi i librit “Mësojmë nga e shkuara 1944-1991”

<https://meteoalb.com/themelohet-ne-korce-klubi-i-librit-mesojme-nga-e-shkuara-1944-1991/>